



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 390/5 Prot

Tiranë, më 17.05.2021

V E N D I M

Nr.53, datë 17.05.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e pjesshëm të ligjshmërisë së procesit të ristrukturimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, pranë Ministrisë së Brendshme, filluar në bazë të informacionit të përcjellë me kërkesën nr. 390 prot., datë 3.3.2021, prej nëpunëses ***.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të pikës 1, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të procesit të verifikimit të informacionit të marrë nga kërkesa e nëpunëses *****,

Vërej se:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 390 prot., datë 3.3.2021, nëpunësja ***** ka parashtruar pretendimin se, transferimi i saj për shkak të ristrukturimit të institucionit, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Shërbimeve”, në Drejtorinë e Administrimit të Regjistrave dhe Kontrollit të Shërbimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, në Ministrinë e Brendshme, është i padrejtë, për tre arsye të përmbledhura prej saj:

Së pari, në strukturën e re ka ndryshuar vetëm emërtesa e sektorit, nga Sektori i Dokumenteve të Identitetit në Sektori i Dokumenteve Biometrike, ndërsa numri i pozicioneve të punës nuk ka ndryshuar;

Së dyti, pavarësisht ristrukturimeve të kryera në vite, jam konfirmuar gjithmonë në të njëjtin pozicion, pasi kam përvojë të gjatë pune në të njëjtin pozicion të shërbimit civil dhe i plotësoj kërkesat e posaçme për vendin e punës;

Së treti, transferimi në një drejtori tjetër dhe pozicion tjetër është bërë në kundërshtim me parashikimet e nenit 50, të ligjit për nëpunësin civil pasi në këtë dispozitë përcaktohet qartë se nëpunësi civil transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil, vetëm në rast se për shkak të ristrukturimit të institucionit, pozicioni i tij i mëparshëm nuk ekziston.

Me pretendimet si më sipër, ajo i është drejtuar Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse dhe Komisionerit, duke kërkuar verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera në këtë rast, për transferimin e përhershëm të saj për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Në kuadër të verifikimit të këtyre pretendimeve, u kërkuar dokumentacioni përkatës në Ministrinë e Brendshme, nga shqyrtimi i të cilit rezultoi e vërtetuar sa më poshtë:

Nëpunësja *****, që nga data 20.11.2006 e në vazhdim, është e punësuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, pranë Ministrisë së Brendshme, duke punuar fillimisht në një pozicion të nivelit “*përgjegjës sektori*”, konfirmuar si nëpunës civil në këtë nivel në datën 24.3.2009 dhe më pas, në kuadër të ristrukturimit të institucionit me aktin nr. 1536/90 prot., datë 4.11.2013, të Departamentit të Administratës Publike, është sistemuar në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Dokumenteve të Identitetit*”, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, në Ministrinë e Brendshme, pozicion në të cilin ka vazhduar të punojë deri në miratimin e strukturës së fundit.

Shkaku i mosmarrëveshjes lidhet pikërisht, me implementimin e urdhërit nr. 16, datë 13.1.2021, të Kryeministrit “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Brendshme*”, në përbërje të të cilës bën pjesë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Njësia e burimeve njerëzore e institucionit, në zbatim të parashikimeve të pikës 15, të kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, nëpërmjet email zyrtar, në datën 15.1.2021, ka njoftuar të gjithë punonjësit e institucionit për miratimin e strukturës së re dhe fillimin e veprimeve për zbatimin e saj.

Ndërkohë, me aktin nr. 10 (387/1 prot.), datë 18.1.2021, të njësisë përgjegjëse (DAP), është ngritur Komisioni i Ristrukturimit, i cili pasi ka shqyrtuar dhe analizuar gjithë rastet për mundësinë e sistemimit të nëpunësve në vendet e lira ekzistuese, të krijuara rishtas apo të ristrukturuara, për nëpunësen *****, ka propozuar transferimin e përhershëm të saj, nga pozicioni “*Specialist në Sektorin e Dokumenteve të Identitetit*”, në Drejtorinë e Sistemeve Informatike, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Shërbimeve*”, në Drejtorinë e Administrimit të Regjistrave dhe Kontrollit të Shërbimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, në Ministrinë e Brendshme. (*Vendim nr. 2007/17 prot., datë 15.2.2021, i Komisionit të Ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme, për propozimin e transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë, pika 84*).

Këtë propozim, e ka miratuar pa vërejtje edhe njësia përgjegjëse, e cila nëpërmjet aktit nr. 1320/1 prot., datë 19.2.2021 (*pika 84 e tij*) dhe aktit individual nr. 1320/85 prot., datë 19.2.2021, ka vendosur transferimin e përhershëm të nëpunëses *****, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Shërbimeve*”, në Drejtorinë e Administrimit të Regjistrave dhe Kontrollit të Shërbimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, në Ministrinë e Brendshme.

Kërkuesja e konsideron këtë transferim të padrejtë, me pretendimin se, pozicioni i saj i mëparshëm, nuk është suprimuar dhe se nuk ka pësuar asnjë ndryshim në qëllim, detyra dhe objektiva, në kërkesa të përgjithshme e të veçanta, etj., ndryshim që do të justifikonte transferimin në një pozicion tjetër dhe për këtë arsye, ka paraqitur ankesën nr. 2007/115 prot., datë 1.3.2021, pranë njësisë përgjegjëse.

Konstatohet se, Departamenti i Administratës Publike, në përgjigje të ankesës së mësipërme, ka sqaruar nëpunësen se emërimi i saj në pozicionin e mëparshëm të punës është i pamundur, pasi nuk plotëson kriteret e veçanta në lidhje me fushën e studimeve universitare apo profilin e arsimit të lartë që ajo ka kryer, pasi në kuadër të ristrukturimit ka ndryshuar përshkrimi i punës. Më tej, njësia përgjegjëse ka sqaruar se në përshkrimin e ri të punës për pozicionin “*Specialist në Sektorin e Dokumenteve Biometrike*”, në kërkesat e posaçme është vendosur, arsimim në fushën e Shkencave Politike, ndërkohë që ajo zotëron diplomë të nivelit “*Master Shkencor*”, në profilin “*Administratë*”, dhe titullin Ekonomist Agrar (*shkresa e DAP, nr. 1320/96 prot., datë 11.3.2021*).

Ky qëndrim i Komisionit të Ristrukturimit dhe arsyetimi i Departamentit të Administratës Publike si më sipër, nuk është në përputhje me rregullat e vendosura në lëgjisllacionin e shërbimit civil, për kushtet që duhen mbajtur parasysh, që Sekretari i Përgjithshëm i institucionit, eprori direkt dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të ndryshojnë kërkesat e veçanta të pozicionit të punës, apo të hartojnë përshkrim të ri pune për një pozicion të shërbimit civil.

Më konkretisht, në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, kreu IV “*Procedura dhe formati i përshkrimit të punës*”, pika 14, përcaktohet se ndryshimet e përshkrimeve ekzistuese të punës apo përshkrimet e reja të punës, hartohen kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit apo kur kanë ndodhur ndryshime ose miratime të legjisllacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni.

Në rastin konkret, pozicioni i mëparshëm i kërkueses *****, kishte emërtimin “*Specialist në Sektorin e Dokumenteve të Identitetit*”, në Drejtorinë e Sistemeve Informatike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, i cili në strukturën e re ka marrë emërtimin

“Specialist në Sektorin e Dokumenteve Biometrike”. Nga krahasimi i dy emërtimeve, duket pothuaj qartë, që ky emërtim i ri, nuk pritet të shoqërohet me ndryshim të kompetencave, të misionit, të qëllimit, objektivave të punës, etj.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile vazhdon të jetë organi më i lartë i sistemit të shërbimit të gjendjes civile. Në mbulimin e këtij funksioni të rëndësishëm ajo funksionon dhe ushtron kompetencat e përcaktuara në nenin 65, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, *“Për gjendjen civile”*, i ndryshuar. Rezulton se, vitet e fundit ky ligj nuk ka pësuar ndonjë ndryshim i cili mund të diktonte edhe nevojën e ndryshimit të përshkrimeve të punës për pozicionet e shërbimit civil në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

Për sqarimin e këtij momenti, pra të shkakut të ndryshimit të kërkesave të vendit të mëparshëm të punës, të cilat kanë shtyrë Komisionin e Ristrukturimit të transferojë nëpunësen *****, nga pozicioni *“Specialist në Sektorin e Dokumenteve të Identitetit”*, në Drejtorinë e Sistemeve Informatike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, në pozicionin *“Specialist në Sektorin e Shërbimeve”*, në Drejtorinë e Administrimit të Regjistrave dhe Kontrollit të Shërbimeve, me shkresat 390/1 prot., datë 9.3.2021 dhe nr. 390/2 prot., datë 16.4.2021, të Komisionerit, u kërkua nga institucioni përshkrimi i ri i punës, i hartuar dhe miratuar sipas rregullave të përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 1, datë 31.5.2017, të Departamentit të Administratës Publike *“Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”*.

Në përgjigje institucioni me shkresën nr. 2059/1 prot., datë 29.4.2021, solli një kopje të formularit të përshkrimit të ri të punës, i cili nuk është i nënshkruar dhe miratuar nga aktorët përkatës (*epropri direkt, Sekretari i Përgjithshëm, njësia e burimeve njerëzore dhe njësia përgjegjëse*). Ky fakt do të thotë se Komisioni i Ristrukturimit, në kryerjen procedurës për transferimin e ankueses është bazuar në një dokument të parregullt, fakt ky që e bën të parregullt gjithë procedurën e transferimit për rastin në fjalë.

Më tej, në përmbajtjen e përshkrimit të ri të punës (*pavarësisht se është i pa miratuar nga nëpunësit përkatës*), në pjesën ku përshkruhet qëllimi i pozicionit të punës, detyrat dhe përgjegjësitë kryesore thuhet shprehimisht: *Menaxhimi i procesit për konsolidimin e mëtejshëm të sistemit të prodhimit dhe shpërndarjes së dokumenteve biometrike/ letërnjoftime elektronike/ pasaporta elektronike; mbikëqyrje e ecurisë së kontratës konçensionare të “Prodhimit e shpërndarjes së dokumenteve të identitetit”; koordinimi i punës me strukturat përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit për pajisjen me dokumente identiteti për shtetasit shqiptarë brenda dhe jashtë vendit.*

Nga krahasimi i përshkrimit të vjetër të punës me përshkrimin e ri, konstatohet se objektivi, misioni, qëllimi i përgjithshëm i pozicionit të punës dhe detyrat kryesore që përcaktojnë arsyen e ekzistencës së pozicionit të punës, nuk kanë pësuar asnjë ndryshim.

Fakti që në strukturën e mëparshme sektori ku punonte kërkuesja (*Sektori i Dokumenteve të Identitetit*), ishte i vendosur në përbërje të Drejtorisë së Sistemeve Informatike, ndërsa në strukturën e re ka kaluar në përbërje të Drejtorisë së Hartimit të Procedurave dhe Dokumenteve Biometrike, ka të bëjë vetëm me emërtesën e pozicionit të punës, pozicionimin në strukturën e institucionit si dhe me mënyrën e mbikëqyrjes dhe të raportimit në linjën e hierarkisë organizative, kurse objekti konkret i punës, përgjegjësitë dhe detyrat që duhet të kryejë nëpunësi, janë të njëjta e në këto rrethana nuk ka ndonjë arsye që të ndryshohen kërkesat e posaçme për vendin e punës.

Së fundi duhet thënë se nëpunësja në fjalë, është e punësuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, që nga data 20.11.2006, fillimisht në nivelin përgjegjës sektori, në Drejtorinë e Dokumentacionit, më pas nga viti 2013 e në vijim ka punuar "*Specialist në Sektorin e Dokumenteve të Identitetit*" dhe pavarësisht nga fakti që struktura dhe organika e Ministrisë së Brendshme ka ndryshuar disa herë ajo në vazhdimësi është konfirmuar në të njëjtin vend pune, pasi siç e kemi arsyetuar edhe më sipër, nuk ka patur ndryshime të legjislacionit të posaçëm mbi bazën e të cilit funksionon DPGJC, ndryshime të cilat do të diktonin edhe ndryshimin e kërkesave të posaçme për vendin e punës.

Në këtë rast është e nevojshme të theksojmë se marrëdhënia e punës së nëpunëses *****, është marrëdhënie ekzistuese, e cila është lidhur në bazë të kushteve dhe kërkesave që kanë qenë përcaktuese në momentin e lidhjes së saj, pas kryerjes së procedurave përkatëse për rekrutimin në shërbimin civil.

Nisur nga parimi i përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, "*garantimi i qëndrueshmërisë në detyrë të nëpunësi civil dhe vazhdimësinë në shërbimin civil*", një marrëdhënie ekzistuese në shërbimin civil mund të çenohet, të ndërpritet apo ndryshohet vetëm në kushtet e përcaktuara në ligj. Është e palejueshme që pa ndonjë shkak të ligjshëm, të ndryshohen kërkesat e posaçme të vendit të punës, e aq më tepër të kryhen veprime administrative mbi bazën e dokumenteve të parregullta, të paligjshme si në rastin konkret. Ndryshimi i kriterit arsimor në rastin konkret është i paargumentuar bindshëm, sidomos në drejtim të kërkesës që specialisti në Sektorin e Dokumenteve Biometrike, duhet të ketë arsim në Shkenca Politike/Marrëdhënie Ndërkombëtare.

Duhet nënvizuar se, procesi i ristrukturimit, është një proces që kryhet në bazë të rregullave të mirpërcaktuara nga legjislacioni i shërbimit civil dhe shërben për riorganizimin e institucionit pas shkurtimit apo shtimit të vendeve të punës, por në asnjë rast, pavarësisht qëllimit që ka organi drejtues, ai nuk mund të shërbejë si shkak për lëvizjen e pambështetur në ligj të punonjësve.

Nisur nga gjithë sa më sipër, arrihet në konkluzionin se, Komisioni i Ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme dhe njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike në veprimet e kryera, për transferimin e përhershëm të nëpunëses *****, nuk kanë respektuar kërkesat e procesit të ristrukturimit, pasi janë mbështetur në një përshkrim pune të parregullt, me kërkesa të posaçme të pambështetura në argumente bindëse.

Për këtë arsye, bazuar në pikën “b”, të nenit 109, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, aktet e dala në këtë proces vlerësohen si akte të paligjshme dhe si të tilla, bazuar në nenin 113, të ligjit në fjalë, duhet të anulohen nga vetë organi publik, duke urdhëruar Komisionin e Ristrukturimit që të rishqyrtojë edhe një herë rastin dhe të propozojë sistemimin e nëpunëses *****, në pozicionin e mëparshëm të punës “Specialist në Sektorin e Dokumenteve Biometrike”, në Drejtorinë e Hartimit të Procedurave dhe Dokumenteve Biometrike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të neneve 109/b/d e 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, si dhe në nenet 16 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

Për rregullimin e situatës së ligjshmërisë, në zbatim të kërkesave të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar e të neneve 109/b/b e 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, të kërkoj nga organi publik Departamenti i Administratës Publike, që të anulojë pjesërisht aktin nr. 1320/1 prot, datë 19.2.2021, “Mbi transferimin e përhershëm të nëpunësve në kuadër të ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme”, në lidhje me transferimin e nëpunëses *****, në kuadër të ristrukturimit, duke vepruar si më poshtë:

- Të anulohet nga njësia përgjegjëse, pika 84, e aktit nr. 1320/1 prot, datë 19.2.2021, në të cilin urdhërohet transferimi i përhershëm i punonjësës *****, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Shërbimeve”, në Drejtorinë e Administrimit të Regjistrave dhe Kontrollit të Shërbimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, në Ministrinë e Brendshme.
- Të kërkohet nga ana e njësisë përgjegjëse DAP, që të kthejë për rishikim të pjesshëm propozimin e Komisionit të Ristrukturimit (Vendim nr. 2007/17 prot., datë 15.2.2021,

i Komisionit të Ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme, për propozimin e transferimit të përhershëm të nëpunësit civil, të përmendur në pikën 84).

- Njësia përgjegjëse të krijojë të gjitha kushtet e të ndjekë ecurinë e procesit administrativ për zbatimin e detyrave të mësipërme, duke i kërkuar Komisionit të Ristrukturimit që në çdo rast, propozimet për transferimin e nëpunësve të bazohen në përshkrimet e punës, të hartuar e të nënshkruar në mënyrë të rregullt nga nëpunësit përgjegjës si dhe gjithë praktikën shkresore mbi bazën e të cilit është marrë vendimi.
- Ky vendim ti njoftohet, Departamentit të Administratës Publike, Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Brendshme, dhe nëpunëses *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha